Hapet thirrja për mobilitete studentësh të UPT-së, në kuadër të Marrëveshjes KA1, të Programit Erasmus+ në University of Chieti, Itali

Në kuadër të Marrëveshjes KA1 bilaterale, është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitetepër studentët e Universitetit Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës, në University of Chieti, (Università degli Studi" G. d'Annunzio" Chieti - Pescara), www.unich.it .

Llojet e mobilitetit përfshijnë: Shkëmbimin e studentëve për studime.

Nivelet e mobilitetit: Studentët duhet të jenë të regjistruar në Fakultetin e Arkitekturës dhe Urbanistikës, viti i katërt dhe i pestë.

Kohëzgjatja e bursave për studentët: Semestri i II i vitit akademik 2026 – 2027, 5 muaj, *(Spring Semester, 01 March–31 July 2027)*

Numri total i studentëve: 2 (Përzgjedhja përfundimtare kryhet nga University of Chieti.)

Dokumentat e nevojshme për aplikim:

- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studenti;
- Listë notash estudimeve, deri në momentin e aplikimit;
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze);
- Certifikatë e gjuhës së huaj* (Italisht ose Anglisht);
- Dokumenti Learning Agreement**.

Përparësi në nominimin e studentëve, si dhe për mbështetje financiare të tyre gjatë mobilitetit, kanë studentët që u përkasin grupeve të disavantazhuara. (Studentë, prindërit e të cilëve kanë vdekur në krye të detyrës; studentë me ndihmë financiare; studentë me nevoja të veçanta; studentë prindërit e të cilëve kanë nevoja të veçanta, studentë që kanë marrë statusin e jetimit; studentë që kanë qenë viktima të trafikimit të qenieve njerëzore; studentë të grupeve etnike; studentë, prindërit e të cilëve ishin të dënuar të regjimit komunist; studentë, prindërit e të cilëve janë në pension etj.)

**Ofrohen kurset e studimit në gjuhën angleze, ku niveli minimal i kërkuar për gjuhën është B1. Studenti duhet të plotësojë nivelin minimal të kërkuar të gjuhës duke e vërtetuar me certifikatën përkatëse të gjuhës së huaj. Preferohen: TOEFL iBT Certificate, Cambridge Certificate, IELTS Certificate.*
***Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërbenpërtëpërcaktuar lëndëtqëdotë zhvilloninëuniversitetinpritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë ''Mobility Plan''. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin Politeknik të Tiranës, kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në University of Chieti lëndë të njëjta ose ekuivalente me ato që do të kryenit në semestrin përkatës në fakultetin tuaj, kjo për arsye që lëndët dhe kreditet t'ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillonit në fakultetin tuaj semestrin përkatës, atëherë kur të ktheheni ju duhet të zhvilloni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin Politeknik të Tiranës.

Dokumenti ''Learning Agreement'' te seksioni ''Commitment'' firmoset nga aplikanti, nga Koordinatori Akademik iFakultetit dhe nga Zv/Rektori i UPT-së për Anën Shkencore dhe Marrëdhëniet me Jashtë.

Për t'u njohur me listën e lëndëve, si dhe për një informacion të plotë mbi University of Chieti ju lutemi klikoni te:

- *General Information: https://en.unich.it/*
- *Courses Held in English: https://www.unich.it/international/international-students/courses-held-english*
- *Course Catalogue: https://unich.coursecatalogue.cineca.it/*
- *EU Academy language test: https://academy.europa.eu/*

https://en.unich.it/teaching

Afati për aplikim, pranë Drejtorisë së Komunikimit dhe Koordinimit në UPT: Deri më 5 nëntor 2026, ora 12.00

Për informacione shtesë në lidhje me procesin e aplikimit në UPT mund të kontaktoni në email:rkodra@upt.al dhe abeqo@upt.al